

VENDIM
Nr. 613, datë 24.10.2018

PËR NJË SHITESË NË VENDIMIN NR. 584, DATË 28.8.2003, TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE, “PËR MIRATIMIN E RREGULLORES SË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE”, TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 23, pika 2, 24, pika 4, e 25, pika 4, të ligjit nr. 9000, datë 30.1.2003, “Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Ministrave”, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në tekstin e rregullore bashkëlidhur vendimit nr. 584, datë 28.8.2003, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, pas pikës 2, të kreut I, “Dispozita të përgjithshme”, shtohet pika 2/1, me këtë përmbajtje:

“2.1 Kompetencat e Sekretarit të Përgjithshëm të Këshillit të Ministrave, të parashikuara në këtë rregullore, përfshirë edhe pjesëmarrjen në mbledhjet e Këshillit të Ministrave, në mungesë dhe me autorizimin e tij, ushtrohen nga drejtuesi në varësi të drejtpërdrejtë, i cili është përgjegjës për çështjet e legjislacionit dhe të akteve rregullatore në Kryeministri.”.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama